

Historia



BIBLA PËRMBAN HISTORINË E PERËNDISË. ËSHTË HISTORIA E
PERËNDISË

NË FILLIM-QË MË PARË SE TË
KRIJOHEJ KOHA-PERËNDIA
ISHTE ATY.


ISHTE AI... QË KRIJOI
QIEJT DHE TOKËN QË NE
SHOHIM SOT

DHE PERËNDIA
THA,"LE TË BËHET
DRITË," DHE DRITA
U BË.

PERËNDIA E NDAU
DRITËN NGA ERRËSIRA
DHE U BË MBRËMJE DHE
MËNGJES-DITA E PARË

PERËNDIA KRIJOI KUPËN QIELLORE
DHE NDAU UJËRAT QË ISHIN POSHTË
SAJ NGA UJËRAT QË ISHIN SIPËR SAJ.
DHE PERËNDIA E QUAJTI KUPËN
QIELLORE "QIELL".

KJO ISHTE
DITA E DYTË E
KRIJIMIT.





PERËNDIA THA, "UJËRAT
QË JANË NËN QIELL TË
GRUMBULLOHEN NË NJË
VEND TË VETËM DHE TË
SHFAQET TERA."

PERËNDIA E QUAJTI TERËN "TOKË" DHE
UJËRAT "DETE."

PASTAJ PERËNDIA FOLI DHE
TOKA PRODHOI GJELBËRIMIN.
BIMËT NXIRRNIN FARË SIPAS
LLOJIT TË TYRE DHE PEMËT
JEPNIN FRUTA QË PËRMB-
ANIN FARA NË TO.

KJO ISHTE DITA E TRETË E
KRIJIMIT



NË DITËN E KATËRT PERËNDIA THA, "
TË KETË NDRIÇUES NË KUPËN
QIELLORE PËR TË NDARË DITËN NGA
NATA, DHE TË SHËRBEJNË SI SHENJA
PËR TË DALLUAR STINËT, DITËT DHE
VITET, DHE TË SHËRBEJNË SI
NDRIÇUES NË KUPËN QIELLORE PËR
TË NDRIÇUAR TOKËN.


PASTAJ NË DITËN E
KATËRT PERËNDIA
KRIJOI TË GJITHË
UNIVERSIN ME DIELLIN,
HËNËN DHE YJET.



NË DITËN E PESTË PERËNDIA THA: "TË MBUSHEN UJËRAT ME QËNIE TË GJALLA DHE TË FLUTUROJNË ZOQJTË NË HAPËSIRËN E MADHE TË KUPËS QIELLORE."

PERËNDIA KRIJOI KAFSHËT E MËDHA UJORE DHE ÇDO GJALLESË QË MBUSH UJËRAT DHE ÇDO SHPEND FLUTURUES SIPAS LLOJIT TË VET.

PERËNDIA I BEKOI DHE U THA TË SHUMËZOHEN DHE TË MBUSHIN UJËRAT DHE ZOQJTË TË SHUMËZOHEN MBI TOKË



NË DITËN E GJASHTË PERËNDIA THA, " TOKA TË PRODHOJË QËNIE TË GJALLA SIPAS LLOJIT TË TYRE: BAGËTI, RRËSHQANORË, BISHA TË TOKËS, SIPAS LLOJIT TË TYRE."

KËSHTU, NË DITËN E GJASHTË PERËNDIA BËRI TË GJITHË KAFSHËT NË TOKË.



NË PO TË NJËJTËN
DITË PERËNDIA
FORMOI NJË TJETËR
KRIJESË NGA PLUHURI
I TOKËS.



NË KËTË KRIJESË
PERËNDIA FRYU
FRYMËN E JETËS
DHE KRIJESA U BË
NJË QËNIE E
GJALLË.





PERËNDIA E QUAJTI KRIJESËN
E RE "NJERI" DHE I DHA EMRIN
"ADAM".

PERËNDIA PA TË GJITHË KRIJIMIN E
TIJ DHE THA, "ËSHTË SHUMË MIRË."

PERËNDIA I DHA NJERIUT PARAJSËN-
ISHTE NJË KOPËSHT QË QUHEJ "EDEN"

PERËNDIA I DHA NJERIUT PUNË
PËR TË BËRË –TË
KUJDESEJ PËR
KOPSHTIN.





NË MES TË KOPSHTIT
PERËNDIA MBOLLI PEMËN
E JETËS-QË SIGURONTË
JETË TË PËRJETSHME. AI
GJITHASHTU MBOLLI NJË
PEMË TJETËR-PEMËN E
NJOHJES TË SË MIRËS
DHE TË SË KEQES

PERËNDIA I THA
NJERIUT SE AI
MUND TË HANTE
NGA ÇDO PEMË
NË KOPËSHT-POR
I DHA ATIJ NJË
PARALAJMËRIM...

NUK DUHET TË HASH NGJA
PEMA E NJOHJES TË SË MIRËS
DHE SË KEQES, SEPSE NËSE
HA PREJ SAJ ME SIGURI KE
PËR TË VDEKUR.




ZOTI SOLLI KAFSHËT E TOKËS
DHE ZOGJTË E QIELLIT TEK
ADAMI QË TË SHIHTE SE SI
DO T'I QUANTE AI.

A man with long dark hair and a beard is lying on his back in a lush green jungle. He is looking up towards the sky with a peaceful expression. The background is filled with dense tropical foliage.

NJERIU I PARË PATI NJË
MIQËSI TË NGUSHTË ME
PERËNDINË

POR PERËNDIA E
DINTE SE NUK
ISHTE MIRË PËR
ADAMIN QË TË
ISHTE VETËM.

PERËNDIA BËRI QË ADAMI TË
BINTE NË NJË GJUMË TË
THELLË-E NDËRSA AI
FLINTE, PERËNDIA MORI NJË
NGA BRINJËT E TIJ.

Adam and Eve are shown in a close-up, facing each other in the Garden of Eden. Adam is on the right, looking at Eve on the left. They are surrounded by vibrant red and yellow flowers. In the background, there are white birds flying in a blue sky, and a tree trunk is visible on the right.

DHE NGA BRINJA E TIJ
AI KRIJOI GRUAN E
PARË.

PERËNDIA E ÇOI ATË TEK NJERIU.

ADAMI E QUAJTI GRUAN E
TIJ TË BUKUR "EVË". AJO DO
TË BËHEJ NËNA E TË GJITHË
NJERËZIMIT.

ATA ISHIN NË KOPËSHT BASHKË DHE ISHIN
SHUMË, SHUMË TË LUMTUR.



POR NJË TJETËR
KRIJESË KËRKONTE
QË TA MBANTE
NJERIUN LARG NGA
LUMTURIA E ZOTIT.

AI ISHTE LUCIFERI
(SATANI)- NJË ËNGJËLL QË
ISHTE REBELUAR KUNDËR
PERËNDISË DHE ISHTE
DËBUAR NGA QIELLI.



AI ERDHI TEK ADAMI DHE EVA NË
KOPËSHT NË FORMËN E NJË GJARPRI.

AKATHËNË ME TË
VËRTETË PERËNDIA, "NUK
DUHET TË HANI NGATË
GJITHA PEMËT NË
KOPËSHT?"



NE MUND TË
HAMË FRUTAT E
PEMËVE TË KOPSHTIT,
POR JO PREJ PEMËS
QË ËSHTË NË MES TË
KOPSHTIT.

NE NUK DUHET
TA PREKIM,
NDRYSHE DO TË
VDESIM.



JU S'KENI PËR TË
VDEKUR ASPAK. PERËN-
DIA E DI SE NËSE DO T'I
HANI, JU DO TË BËHENI SI
AI, DO TË NJIHNI TË MIRËN
DHE TË KEQEN.

SI BURRI ASHTU EDHE
GRUAJA HËNGRËN
FRUTIN E NDALUAR
DHE SI REZULTAT...

A man and a woman, both with long dark hair and wearing green leaf-like tunics, are running through a lush, dense garden. The man is in the foreground, looking back over his shoulder, while the woman follows him. The background is filled with large trees, vines, and various plants.

MËKATI ERDHI NË BOTË
PËRMES MOSBINDJES.
ATA TANI E KUPTUAN SE
ISHIN LAKURIQ DHE U
TREMBËN.

POR EDHE KUR MËKATI
HYRI NË FILLIM NË
BOTË, PERËNDIA
SIGUROI SAKRIFICËN.

A scene showing two dead animals, possibly deer or antelope, lying on the ground in a forest. The ground is muddy and the surrounding vegetation is dense and green.

AI BËRI TUNIKA PREJ
LËKURE PËR T'I
MBULUAR NJERËZIT
DHE MËKATIN E
TYRE. AI PO ASHTU
NXORRI ADAMIN DHE
EVËN NGA KOPSHTI.

POR AI PREMTOI SE
NJË SHPËTIMTAR
NË TË ARDHMEN DO
TË VINTE DHE DO
TË SHKATËRRONTE
SATANIN.


A large, green, scaly dragon with a long neck and a forked tongue. It is standing on its hind legs and looking towards the right. The background is a plain, light brown color.

DO TË KETË
ARMIQËSI MIDIS TEJE
DHE GRUAS E MIDIS
TEJE DHE PASARD-
HËSVE TË SAJ.

FARA E SAJ
DO TË SHTYPË
KOKËN TËNDE, DHE TI
DO TË PLAGOSËSH
THEMBRËN E FARËS
SË SAJ.

A muscular man with long blonde hair, wearing a yellow tunic and a large, ornate belt. He has large, feathered wings on his back and is holding a glowing sword in his right hand. He is standing in a room with a large window in the background.

PËR TU SIGURUAR QË NJERËZIT NUK DO TË
RIKTHEHESHIN NË KOPËSHT , PERËNDIA
VENDOSI NJË ËNGJËLL NË HYRJE QË TË
RUANTE RRUGËN PËR TEK PEMA E JETËS.



POPULLSIA U RRIT DHE
TOKA U MBUSH ME
DHUNË. PERËNDIA ISHTE
HIDHËRUAR ME MËKATIN
DHE REBELIMIN E
NJERIUT



AI VENDOSI TI JAPË FUND
RRACËS NJERËZORE-DUKE
DËRGUAR NJË PËRMBYTJE TË
MADHE NË TË GJITHË TOKËN.

POR NJË NJERI GJETI HIR NË SYTË E
PERËNDISË. PERËNDIA I THA NOAS QË
TË NDËRTONTE NJË VARKË TË MADHE.



POR NJË NJERI GJETI HIR NË SYTË E
PERËNDISË. PERËNDIA I THA NOAS QË
TË NDËRTONTE NJË VARKË TË MADHE.

PERËNDIA SOLLI NJË PËRMBYTJE TË MADHE
DHE ÇDO QËNIE E GJALLË QË NUK ISHTE NË
ARKË, NJERI DHE KAFSHË, U MBYT



PERËNDIA SHPËTOI DY
NGA ÇDO LLOJ KAFSHË
DHE PO ASHTU NOAN
DHE FAMILJEN E TIJ.

PERËNDIA PASTAJ I THA NOAS
DHE FAMILJES SË TIJ, "JINI TË
FRYTSHËM DHE SHUMOHUNI
DHE MBUSHNI TOKËN."

NGA KJO FAMILJE E
VETME ERDHËN TË
GJITHA KOMBET E
TOKËS.

POR SËRISH,
NJERËZIT
VENDOSËN QË TË
MOS I BINDESHIN
PERËNDISË.



PERËNDIA U THA NJERËZVE
QË TË MBUSHNIN TOKËN
DHE TË SHUMOHESHIN.
POR NJERIU NUK JU BIND
URDHËRIT TË PERËNDISË.

NË VEND SE TË SHPËRND-
HESHIN NË TË GJITHË TOKËN
ASHTU SIÇ PERËNDIA
URDHËROI, ATA QËNDRUAN
NË NJË TOKË PJELORE TË
QUAJTUR BABILONI.



ATA NISËN TË NDËRTONIN NJË
KULLË GJIGANDE PËR TË BËRË NJË
EMËR PËR VETEN E TYRE NË VEND
SE TI BINDESHIN PERËNDISË.

NE NUK KEMI NEVOJË
PËR PERËNDINË QË TË
MBRETËROJ MBI NE. NE
DO TË NDËRTOJMË NJË
QYTET TË MADH DHE NJË
KULLË KËTU.

ATA KISHIN NJË UDHËHEQËS QË
QUHEJ NIMROD QË I INKURA-
JONTE TË ISHIN REBELË.



POR PERËNDIA ZBRITI
POSHTË TEK KULLA E
BABELIT DHE NGATËRROI
GJUHËN E TYRE.



NË VEND TË NJË GJUHE ATA
KISHIN SHUMË GJUHË DHE
NJERËZIT QË FLISNIN TË NJËJTËN
GJUHË NISËN TË UDHËTOJNË SË
BASHKU MBI TOKË.



PLANI I PERËNDISË PËR TË SHPEN-
GUAR NJERËZIMIN NISI QË ME PËRZG-
JEDHJEN E NJË NJERIU-ABRAHAMIT.
PERËNDIA PREMTOI...

"UNË DO TË BËJ NGATY
NJË KOMB TË MADH."

PERËNDIA I PREMTOI ATIJ
AQ SHUMË PASARDHËS
SAYJET NË QIELL.

NJË NGA PASARDHËSIT E TIJ TË MËVON-
SHËM DO TË BËHEJ NJË SAKRIFICË PËR
MËKATIN E TË GJITHË BOTËS.

KUR ABRAHAMI ISHTE 100
VJEÇ, LINDI BIRI QË PERËNDIA
KISHTË PREMТУAR

POR PASTAJ PERËN-
DIA TESTOI
ABRAHAMIN.

"MERRE BIRIN TËND
DHE SAKRIFIKOJE ATË
SI NJË OFERTË"

ABRAHAMU U BIND-DUKE BESUAR SE PERËNDIA
DO TA RINGJALLTE DJALIN E TIJ NGA TË VDEKURIT.

SAPO ABRAHAMU U BË GATI QË TË
SAKRIFIKONTE BIRIN E TIJ...

"ABRAHAM! MOS I BËJ
ASNJË TË KEQE ATIJ."

ABRAHAMU NGRITI SYTË DHE PA SE PAS
TIJ ISHTE NJË DASH I ZËNË NË NJË
KAÇUBE QË AI MUND TA SAKRIFIKONTE
PËR PERËNDINË.

"TANI E DI MIRË QË TI I
TREM BESH PERËNDISË, SEPSE
TI NUK MË REFUZOVE BIRIN
TËND."

ABRAHAMU DHE BIRI I TIJ
OFRUAN SAKRIFICËN QË
PERËNDIA SIGUROI.



PASARDHËSIT E ABRAHAMIT U
RRITËN SHUMË, ASHTU SIÇ
PERËNDIA KISHTE PREMTUAR.


NJË ZI BUKE BËRI QË ATA TË
SHKONIN NË EGJIPT KU
VAZHDUAN TË SHUMOHEN.

NDËRKOHË QË ISHIN NË
TOKEN E EGJIPTIT ATA U
SHTYPËN DHE U TRAJTU-
AN ME EGËRSI NGA
UDHËHEQËSIT E EGJIPTIT.



POR KUR ISHTE KOHA E
DUHUR , PERËNDIA NGRITI
MOISIUN QË TË DREJTONTE
NJERËZIT JASHTË EGJIPTIT.

PERËNDIA BËRI MREKULLI TË
MËDHA PËR TË TREGUAR SE ISHTE
AI QË PO I ÇLIRONTE NJERËZIT
DUKE I KTHYER ATA NË TOKEN QË I
KISHTE PREMTUAR ABRAHAMIT.



PERËNDIA DHA DISA LIGJE
TË VEÇANTA-10
URDHËRIMET-BASHKË ME
UDHËZIME SE SI TË DUASH
PERËNDINË DHE TË
TRAJTOSH NJERËZIT.

AI PO ASHTU U TREGOI ATYRE
MËNYRËN E DUHUR PËR TË
ADHURUAR DHE PËR TË OFRUAR
SAKRIFICA QË ATA TË KUJTONIN
MËKATIN E TYRE.

HAVE NO
OTHER GODS
BEFORE ME.

DO NOT MAKE
FOR THYSELF IDOLS.

DO NOT TAKE
THE NAME OF GOD
IN VAIN.

KEEP THE
SABBATH DAY
HOLY.

HONOR THY FATHER
AND MOTHER.

DO NOT MURDER.

DO NOT COMMIT
ADULTERY.

DO NOT STEAL.

DO NOT BEAR
FALSE WITNESS
AGAINST YOUR
NEIGHBOR.

DO NOT COVET
THAT WHICH IS YOUR
NEIGHBOR'S.



PERËNDIA I KTHEU NJERËZIT
NË TOKËN QË I KISHTE
PREMTUAR ABRAHAMIT.

POR EDHE PASI NJERËZIT E
PERËNDISË E KISHIN PARË
ZOTIN TË BËNTE VAZHDIMISHT
MREKULLI-ATA NUK JU BINDËN
LIGJIT TË TIJ.



ATA ADHURONIN PERËNDI TË RREMË
DHE BËNIN GJËRA MËKATARE.

ATA E BËNË KËTË PËR
NJË KOHË TË GJATË.

PJESA MË E MADHE E
NJERËZVE THANË SE ATA
NUK DONIN QË T'I
BINDESHIN LIGJIT TË
PERËNDISË QË ZOTI KISHTE
DHËNË PËRMES MOISIUT.



DISA NGAMBRETËRIT DHE
UDHËHEQËSIT E TYRE E DESHËN
DHE E NDOQËN PERËNDINË DHE
BËNË GJËRA TË MËDHA....



... MADJE VRANË EDHE
GJIGANDË.



MBRETËR TË TJERË
ZGJODHËN TË NDIQNIN
PERËNDI TË RREMË DHE I
DREJTUAN NJERËZIT TEK
ADHURIMI I IDHUJVE.


POR DUKE QENË SE I
DONTË-PERËNDIA
DËRGOI PROFETËT TEK
NJERËZIT E TIJ.

KËTA ISHIN NJERËZ TË DËRGUAR
NGA PERËNDIA PËR TË KTHYER
ZEMRAT E NJERËZVE DREJT ZOTIT
DHE PËR T'I LARGUAR NGJA
GJËRA E KËQJA QË PO BËNIN.

A scene of destruction with soldiers on a ramp. The background shows a city in flames and a large, dark, cylindrical object in the sky.

NJERËZIT QË PERËNDIA KISHTE ZGJEDHUR PËR T'I PËRDORUR PËR TË ZBULUAR VETEN E TJ NË BOTË NUK I DËGJUAN PROFETËT E ZOTIT.-EDHE PSE AI I DËRGONTE VAZHDMISHT.

MË NË FUND-PERËNDIA DËRGOI NJË MBRET TË TMERRSHËM DHE USHTRI PËR TË SHKATËRRUAR QYTETIN E TYRE TË VEÇANTË DHE TEMPULLIN KU ADHURO-HEJ ZOTI.

A city at night with a large moon and a giant statue. The city is in flames, and a large, golden statue of a man stands in the background. A large crowd of people is in the foreground, and a large fire is burning in the center.

PËR 70 VITE NJERËZIT E VEÇANTË TË PERËNDISË ISHIN ROBËR NË NJË TOKË TË LARGËT SI NJË DËNIM PËR MËKATIN E TYRE TË REFUZIMIT TË PERËNDISË DHE URDHËRIMEVE TË TIJ.

A scene of destruction with people in the foreground. The background shows a city in flames and a large, dark, cylindrical object in the sky.

POR ASHTU SIÇ AI KISHTE PREMTU-AR, PERËNDIA I KTHEU NE ATDHEUN E TYRE PAS 70 VJETËSH.

GJATË KËSAJ KOHË PERËNDIA DËRGOI PROFETË DHE MËSUES PËR TU THËNË SE SI DUHET TË JETONIN.



PASTAJ PATI 400 VJET
HESHTJE KUR PERËNDIA NUK
DËRGOI MË PROFETË.




GJATË KËTYRE 400 VITEVE QYTETËRIMI GREK
NËN UDHËHEQJEN E ALEKSANDRIT TË MADH
U BË SHUMË I FUQISHËM DHE KONTROLLON-
TE PJESËN MË TË MADHE TË LINDJES SË
MESME KU JETONIN NJERËZIT E ZOTIT.



PASTAJ QEVERIA ROMAKE ERDHI NË
FUQI DHE USHTRITË E TYRE PUSHTU-
AN GREKËT, IZRAELIN, E SHUMË
VENDE TË TJERA.

POR NË KËTË KOHË
PERFEKTE NË HISTORI.

PERËNDIA DËRGOI
SAKRIFICËN E TIJ PERFE-
KTE NË BOTË.



KJO SAKRIFICË NUK DO TË ISHTE
SI GJAKU I DHIVE APO I DEMAVE
QË NJERËZIT KISHIN OFRUAR PËR
MËKATIN E TYRE.

KJO DO TË ISHTE SAKRIFICA
E PERËNDISË – NJË
SAKRIFICË HYJNORE QË DO
TË LARGONTE TË GJITHË
MËKATET E BOTËS.

ZOTI NUK I KISHTE HARRUAR
NJERËZIT E TIJ.



QË PREJ FILLIMIT, QË NGA BURRI
DHE GRUAJA E PARË, ÇDO NJERI
KISHTE BËRË TË KEQEN DHE ISHTE
PREKUR NGA MËKATI.

PËR KËTË ARSYE, PERËNDISË I
DUHEJ TË SILLTE NJË SAKRIFICË
PA MËKAT NË BOTË.



DUHET TË ISHTE NJË QENIE
NJERËZORE E PA PREKUR
NGA MËKATI.

ZOTI E SOLLI SAKRIFICËN E TIJ NË BOTË
NË NJË MËNYRË SHUMË UNIKE.



PËR TË BËRË KËTË PERËNDIA
ZGJODHI NJË GRUA TË RE TË
VEÇANTË. NJË GRUA QË NUK KISHTE
QENË KURRË ME NJË BURRË. -KËSH-
TU QË FËMIJA NUK DO TË KISHTE
BABA, NJË NJERI MËKATAR.

FRYMA E SHENJTË ERDHI
MBI KËTË GRUA TË RE,
MARINË, E BËRI QË AJO TË
KISHTE NJË FËMIJË.

UNË JAM SHËRBËTOR-
JA E PERËNDISË, LE TË
BËHET ASHTU SIÇ THE.




LINDJA E KËTIJ
FËMIJE TË
VEÇANTË U
LAJMËRUAN NGA
ËNGJËJT.

LAVDI PERËNDISË
NË VENDET MË TË
LARTADHE PAQE NË
TOKË NJERËZVE MBI TË
CILËT QËNDRON
MIRËDASHJA E TIJ.

EMRI I BIRIT TË SAJ
DO TË ISHTE
JEZUS-AI ISHTE BIRI I
PERËNDISË.



AI ISHTE NJË FËMIJË I VEÇANTË, E QË
KUR ISHTE NJË FËMIJË, MËSOI
UDHËHEQËSIT FETARË TË KOHËS.



NË KOHËN PERFЕКTE TË
PERËNDISË, AI U PAGËZUA
DHE FILLOI TË PLOTËSOJË
PJESËN E TIJ NË
HISTORI-PËR TI TREGUAR
NJERËZVE SI ISHTE PERËN-
DIA, E PËR TU BËRË
SAKRIFICA PËR MËKATET E
NJERËZIMIT.



SATANI U SHFAQ SËRISH,
ASHTU SIÇ BËRI ME ADAMIN
DHE EVËN, PËR TI JOSHUR
ATA DREJT MËKATIT QË TË
NDIQNIN RRUGËT E TIJ DHE
JO TË ZOTIT.

UNË MUND TË TË
JAP TË GJITHË
MBRETËRITË E BOTËS
DHE SHKËLQIMIN E
TYRE, VETËM NËSE MË
ADHURON MUA.

ADHURO PERËNDINË
TËND DHE SHËRBEJI
VETËM ATIJ.



JEZUSI NISI TI MËSOJË
NJERËZIT, GRATË,
DJEMTË DHE VAJZAT SESI
PERËNDIA DËSHIRONTE
QË ATA TË JETONIN.

TË BEKUAR JANË
TË MËSHIRSHMIT SEPSE
ATA DO TË GJEJNË
MËSHIRËN.

TË BEKUAR JANË
ATË QË JANË TË PASTËR
NË ZEMËR, SEPSE ATA
DO TË SHOHIN PERËND-
INË.

TË BEKUAR JANË
PAQEBËRËSIT, SEPSE ATA
DO TË QUHEN BIJ TË
PERËNDISË.

TEKSA JEZUSI ISHTE NË TOKË AI I TREGOI
NJERËZVE SESI TË NDIQNIN ZOTIN DHE SI
TË DONIN TË TJERËT.

SA HERË IA KENI
BËRË KËTË NDOJËRIT PREJ
KËTYRE VËLLEZËRVE TË MI
MË TË VEGJËL, KËTË MA
BËTË MUA.

KUSH MË KA
PARË MUA, KA
PARË ATIN

AI PO ASHTU TREGOI SE SI ISHTE PERËNDIA:

AI USHQEU NJERËZ.

AI SHËROI NJERËZ.

AI ECI MBI UJË.

GULÇIM!!

AI NGRITI TË
VDEKURIT.

DJALI TANI
ËSHTË GJALLË.

VETËM PERËNDIA
ËSHTË I AFTË TË BËJË
NJË MREKULLI TË
TILLË.

AI I DESHI DHE I BEKOI FËMIJËT.



AI I TREGOI NJERËZVE PËR PARAJSËN.

AI U TREGOI NJERËZVE PËR FERRIN.



TË LUTEM DËRGOJE
LLAZARIN TË LAGË MAJËN
E GISHTIT TË VETË NË UJË
QË TË MË FRESKOJË
GJUHËN.


DËRGOJE
LLAZARIN TEK
VËLLEZËRIT E MI...

QË T'I LAJMËROJË
ATA PËR KËTË VEND TË
TMERRSHËM.

AI MADJE DËBOI
DEMONË NGA
NJERËZIT.



NË ÇDO MËNYRË AI TREGOI
SE ISHTE PERËNDI.



JEZUSI THA SE ISHTE
PERËNDI, KJO I BËRI
UDHËHEQËSIT FETARË TË
ZEMËROHESHIN SHUMË.

JEZUSIT JU BË
NJË GJYKIM FALS
DHE U AKUZUA PA
TË DREJTË.

AI U FSHIKULLUA, U
RRAH DHE U
GOZHDDUA I GJALLË
NË NJË KRYQ.

KU AI VDIQ.

ATË – NË
DUART E TUA
DORËZOJ
FRYMËN TIME.

SATANI, UDHËHEQËSIT
FETARË, ROMAKËT DHE
MËKATI YNË E VRANË
JEZUSIN.

ATA MENDUAN SE DUKE E
VRARË DO T'I JEPNIN FUND
MESAZHIT TË TIJ DHE
QËLLIMEVE TË PERËNDISË.

POR ATA GABOHESHIN...



ATA VETËM KISHIN PËRM-
BUSHUR ATË QË PERËNDIA
KISHTE PLANIFIKUAR PREJ
KOHËSH-QË NGA
FILLIMI-NË KOPËSHT.

PAJTIMIN E PERËNDISË ME NJERIUN
DUKE SIGURUAR SAKRIFICËN
PERFECTE PËR MËKATIN.

JEZUSI ISHTE KJO
SAKFRIFICË PERFECTE DHE
PA MËKAT.

DHE AI E PROVOI
KËTË DUKE U
NGRITUR NGA TË
VDEKURIT.

PAS VDEKJES JEZUSI JU
SHFAQ NDJEKËSVE TË TIJ.

DHE U DHAATYRE UDHËZIME
QË TU TREGONIN NJERËZVE TË
TJERË PËR FJALËT E TIJ, PËR
JETËN E TIJ-E PËR VDEKJEN
DHE RINGJALLJEN E TIJ.

SHKONI, PRA, DHE
BËNI DISHEPUJ NGA TË
GJITHË POPJUT, DUKE I
PAGËZUAR NË EMËR TË ATIT
E TË BIRIT E TË FRYMËS SË
SHENJTË DHE DUKE I
MËSUAR TË ZBATOJNË TË
GJITHA GJËRAT QË UNË JU
KAM URDHËRUAR.

DHE JA, UNË JAM ME
JU TË GJITHË DITËT, DERI
NË MBARIM TË BOTËS.

TË GJITHË ATA QË
THËRRASIN EMRIN E
ZOTIT DO TË
SHPËTOHEN.

UNË DUA TË
THËRRAS EMRIN E
ZOTIT.

JEZUS!

EDHE UNË!

PASI AI U LARGUA NGA
TOKA NDJEKËSIT E TIJ
KËTË BËNË-DHE SHUME
NJERËZ BESUAN.

JEZUSI THA SE AI DO TË KTHEHEJ
NË TOKË PËR TË GJITHË ATA QË E
DONIN DHE E BESONIN ATË.

KUR AI TË KTHEHET,
PARAJSA DO TË
KTHEHET.

NJERËZIT, KAFSHËT, E
GJËRA TË TJERA QË KEMI
DASHUR DO TË JENË ATJE.

DO TË KETË NJË
QIELL TË RI DHE NJË
TOKË TË RE.

TË GJITHË NJERËZIT, TË RINJ
APO TË VJETËR QË KANË
NDJEKUR JEZUSIN DO TË JENË
ATY-PËRGJITHMONË.

A DO TË JESH
EDHE TI?



UNË JAM UDHA,
E VËRTETA DHE
JETA, ASKUSH NUK
VJEN TEK ATI
PËRVEÇSE NËPËRM-
JET MEJE.

KUSHDO QË
BESON DHE
PAGËZOHET
DO TË SHPË-
TOHET

SEPSE BIRI I
NJERIUT DO TË
KTHEHET NË
LAVDINË E ATIT, ME
ËNGJËJT E TIJ DHE
DO TË SHPËRBLEJË
GJITHSECILIN SIPAS
VEPRAVE TË TIJ.

SI MUND TA NJOH ZOTIN DUKE NDJEKUR JEZUSIN?

NDIQ KËTO HAPA:

- 1 THUAJ JEZUSIT SE TË VJEN KEQ PËR GJËRAT E KËQIJA QË KE BËRË DHE SE DËSHIRON TË LARGOHESH PREJ TYRE DHE TË AFROHESH TEK AI.
- 2 KËRKOJI JEZUSIT TË TË FALË DHE THUAJI ATIJ SE DËSHIRON QË TA NDJEKËSH PËR TË GJITHË JETËN TËNDE.
- 3 FALENDEROJE JEZUSIN QË TË DËGJON DHE QË I PËRGJIGJET LUTJES TËNDE.
- 4 PËR ÇDO DITË LEXO BIBLËN-HISTORINË E ZOTIT.
- 5 THUAJI DIKUJT QË E DO JEZUSIN ÇFARË KE BËRË DHE NIS TË TAKOHESH ME NJË GRUP NJERËZISH TË TJERË QË E DUAN JEZUSIN.

